



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 bazuar në shkresën e Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 06.10.2025, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

## VENDIM PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES

### Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e Draft-Planit Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integritit të të huajve në Komunën e Lipjanit 2026-2028, në përbërje si vijon:

1. Shkëlzen Hajdini, Drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kryesues
2. Lidiya Jovanoviqi, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
3. Arbëresha Hetemi, Zyra Lokale për Komunitete, anëtar
4. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
5. Behar Aliu, Drejtorati për Administratë, anëtar

### Neni 2 Detyrat e grupit punues

Grupi punues ka për detyrë hartimin Draft-Planit Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integritit të të huajve në Komunën e Lipjanit 2026-2028 në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore në fuqi më së largu deri me datën 20.02.2026.

### Neni 3 Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyra Lokale për Komunitete, kryesuesi dhe anëtarët e Grupit punues.

1Nr. 026/04-2501  
Lipjan, më 19.01.2026

KRYETARI I KOMUNES  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

### VENDIM

#### MBI PËRCAKTIMIN E POZICIONEVE PËR FURNIZIM ME KARTELA MBUSHËSE PËR TELEFONA MOBIL PËR VITIN 2026

I. Me këtë Vendim për vitin 2026, përcaktohet shuma mujore e mbushjeve për telefonat mobil për përdorim zyrtar për bartësit e funksioneve në vijim:

| Nr  | Funksioni                                                                              | Nr i Kryersve | Shuma mujore |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------------|
| 1.  | Nënkryetarët e Komunës                                                                 | 2             | 30 €         |
| 2.  | Kryesuesi i Kuvendit                                                                   | 1             | 20 €         |
| 3.  | Drejtorët e Drejtorateve                                                               | 13            | 20 €         |
| 4.  | Drejtor i QKMF-së në Lipjan                                                            | 1             | 20 €         |
| 5.  | Drejtor i Qendrës për punë Sociale në Lipjan                                           | 1             | 20 €         |
| 6.  | Zëdhënës i Komunës                                                                     | 1             | 20 €         |
| 7.  | Inspektor i Ndërtimtarisë                                                              | 1             | 10 €         |
| 8.  | Inspektor i Trafikut                                                                   | 2             | 10 €         |
| 9.  | Inspektor i Mjedisit - ambientit                                                       | 1             | 10 €         |
| 10. | Inspektor i tregut                                                                     | 2             | 10 €         |
| 11. | Shef i Kabinetit të Zyrës së Kryetarit të Komunës                                      | 1             | 10 €         |
| 12. | Shef i Zyrës Lokale për Komunitete                                                     | 1             | 20 €         |
| 13. | Shofer i Kryetarit të Komunës                                                          | 1             | 10 €         |
| 14. | Asistente e Kryetarit të Komunës                                                       | 1             | 10 €         |
| 15. | Numri Kujdestar në Qendrën për punë Sociale                                            | 1             | 10 €         |
| 16. | Menaxher të projekteve- kontrateve (Drejtorati për Infrastrukturë)                     | 3             | 10 €         |
| 17. | Menaxher të projekteve-kontratave Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim | 3             | 10 €         |
| 18. | Menaxher në Shtëpinë e Komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në Lipjan       | 1             | 10 €         |
| 19. | Numri për ekipin e kujdesit palativ në QKMF                                            | 1             | 5 €          |
| 20. | Numri në recepcion për termine për kujdesin palativ në QKMF                            | 1             | 5 €          |

II. Pagesat për mbushje telefonike do të bëhen nga kategoritë buxhetore të pozicioneve mallra dhe shërbime të funksioneve të cekura përkatësisht Drejtorateve përkatëse për çdo muaj të punës .

III.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohen: Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Prokurim, Menaxheri i kontratës për furnizim me mbushje elektronike dhe bartësit e funksioneve të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi.

1Nr. 030/01-2572

Lipjan, më 19.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

### VENDIM

#### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

##### Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **10,080.00€**, (dhjetë mijë e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-140 e datës 05.01.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 36 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin dhjetor të vitit 2025 me nga 280 euro për secilin rast  $36 \times 280 = 10,080.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

##### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

##### Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

##### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

##### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-140  
Lipjan, më 08.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1  
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike "17 Shkurti -Dita e Pavarësisë 2026" Nr.05-453/01-69421 të datës 24.12.2025, në përbërje si vijon:

1. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Govori Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Vjosa Gashi nga OJQ-të anëtare
5. Saranda Karpuzi, në cilësinë e ekspertës të jashtme, anëtare
6. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtarë rezervë

**Neni 2  
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike "17 Shkurti - Dita e Pavarësisë 2026" Nr.05-453/01-69421 të datës 24.12.2025, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3  
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-3158  
Lipjan, më 20.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

### **VENDIM**

### **PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT**

#### **Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **10,080.00€**, (dhjetë mijë e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-140 e datës 05.01.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 36 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin dhjetor të vitit 2025 me nga 280 euro për secilin rast  $36 \times 280 = 10,080.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

#### **Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

#### **Neni 3**

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-140  
Lipjan, më 08.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET NË FUSHËN E BUJQËSISË NË KOMUNËN E LIPJANIT

I. Formohet Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e ditëve të fundit (janar 2026), të cilat kanë ndodhur si pasojë e të reshurave të pandërprera në territorin e Komunës së Lipjanit në fushën e bujqësisë, në këtë përbërje:

1. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqesi dhe Pylltari, Kryesues
2. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor -juridik, anëtar dhe
3. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat, anëtar

II. Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera do ti kryej detyrat si në vijim:

- Të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në fushën e bujqësisë,
- Të hartoj procesverbal për secilin rast të evidentuar duke i bashkëngjitur edhe fotot,
- Të jetë në koordinim të vazhdueshëm me Komisionin Komunal i themeluar në nivel komunal për vlerësimin e dëmeve.

III. Komisioni pas kryerjes së detyrave të cekura në pikën II duhet të hartoj raport me shkrim të cilin do ti a dërgoj Kryetarit të Komunës dhe Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Raportit i bashkëngjitet procesverbali me foto për secilin rast veq e veq.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-1686

Lipjan, më 12.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore ,nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE –TË**  
**KOMUNËS**

**Neni 1**

**Përbërja e Komisionit**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për pranimin e pasurisë jofinanciare të Komunës duke përjashtuar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF-në, Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore- ngecje në zhvillim mendor, Shkollat dhe Çerdhen publike , në këtë përbërje:

1. Adelina Rexhepi, Kryesuese
2. Shefki Sadiku, anëtar
3. Arbëresha Hetemi, anëtare
4. Menaxheri/a i kontratës

**Neni 2**

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për vitin 2026 dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblenjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblenjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

→ INr. 020/04-698  
Lipjan, më 06.01.2026

KRYETARI KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/ L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera , nenit 8 paragrafi 2, pika 2 dhe nenit 10 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM**  
**PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E**  
**DËMEVE**

**Neni 1**

Me këtë Vendim, themelohet, Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Lipjanit, në këtë përbërje;

1. Sadri Shamolli - Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim kryesues
2. Afrim Sadiku – Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari , anëtar
3. Hazbi Ademi, - Zyra e Kryetarit, anëtar
4. Burim Kodra – Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
- 5.Sazana Demiri Rexhepi - Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, sekretare.

**Neni 2**

Komisioni nga neni 1 e këtij Vendimi, në pajtim me nenin 9 të Rregullores 17/2015 emërohet për periudhën 4 vjeçare.

**Neni 3**

Detyrat e komisionit janë përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 si dhe neneve tjera të kësaj Rregulloreje të cilat kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve komunal për vlerësimin e dëmeve.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.020/04-32090 i datës 05.07.2024.

INr. 020/04-1703

Lipjan, më 12.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET NË EKONOMITË FAMILJARE NË KOMUNEN E LIPJANIT

I. Formohet Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e ditëve të fundit, (janar 2026), të cilat kanë ndodhur si pasojë e të reshurave të pandërprera në territorin e Komunës së Lipjanit në ekonomitë familjare, në këtë përbërje:

1. Xhelil Murati, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesues
2. Armend Aliu, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtar dhe
3. Bedri Hetemi, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
4. Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
5. Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare

II. Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera do ti kryej detyrat si në vijim:

- Të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare,
- Të hartoj procesverbal për secilin rast të evidentuar duke i bashkëngjitur edhe fotot,
- Të jetë në koordinim të vazhdueshëm me Komisionin Komunal i themeluar në nivel komunal për vlerësimin e dëmeve.

III. Komisioni pas kryerjes së detyrave të cekura në pikën II duhet të hartoj raport me shkrim të cilin do ti a dërgoj Kryetarit të Komunës dhe Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Raportit i bashkëngjitet procesverbali me foto për secilin rast veq e veq.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-1708

Lipjan, më 12.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD.HOC PËR EVIDENTIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET NË INFRASTRUKURËN E KOMUNES SË LIPJANIT

I. Formohet Komisioni ad.hoc për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e ditëve të fundit, (janar 2026), të cilat kanë ndodhur si pasojë e të reshurave të pandërprera në territorin e Komunës së Lipjanit, në fushën e infrastrukturës, në këtë përbërje:

1. Besart Zejnullahu, Drejtorati për Shërbime , Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesues
2. Rinor Hajrizi, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtar dhe
3. Behar Mjeku, Drejtorati për Inspektorat, anëtar

II. Komisioni për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera do ti kryej detyrat si në vijim:

- Të bëjë evidentimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturën fizike,
- Të hartoj procesverbal për secilin rast të evidentuar duke i bashkëngjitur edhe fotot.
- Të jetë në koordinim të vazhdueshëm me Komisionin Komunal i themeluar në nivel komunal për vlerësimin e dëmeve.

III. Komisioni pas kryerjes së detyrave të cekura në pikën II duhet të hartoj raport me shkrim të cilin do ti dërgon Komisionit Komunal të themeluar në nivel komunal për vlerësimin e dëmeve. Raportit i bashkëngjitet procesverbali me foto për secilin rast veq e veq.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në infrastrukturën e Komunës së Lipjanit 1Nr.020/04-1706 i datës 12.01.2026.

1Nr. 1Nr.020/04-1706/2

Lipjan, më 12.01.2026



KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

## **VENDIM PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES**

### **Neni 1**

#### **Përbërja**

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Draft – Programit Komunal trevjeqar për Banim 2025-2028, në përbërje si vijon:

1. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesues,
2. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor juridik, anëtar,
3. Hanushe Berisha, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
4. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
5. Valdete Muji, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare,
6. Arbëresha Hetemi, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
7. Zyrafete Mavriqi Bytyqi, Qendra për punë Sociale, anëtare

### **Neni 2**

#### **Detyrat e grupit punues**

1. Grupi punues ka për detyrë hartimin e Draft – Programit Komunal trevjeqar për Banim 2025-2028, duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore në fuqi më së largu deri më 15.03.2026.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

### **Neni 3**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr. 020/01-2236  
Lipjan, më 14.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

## VENDIM PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

### Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Draft – Rregullores për Taksat Komunale, në përbërje si vijon:

1. Fauz Xhemajli, Drejtorati për Administratë, Kryesues,
2. Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare
3. Hanushe Berisha, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
4. Burim Gashi , Drejtorati për Administratë, anëtar,
5. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
6. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare
7. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor juridik, anëtar
8. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare.
9. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, anëtar

### Neni 2 Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë hartimin e Draft - Rregullores së re për Taksat komunale në Komunën e Lipjanit, duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi më së largu deri më 28.02.2026.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

### Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr. 020/04-1319  
Lipjan, më 09.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**VENDIM  
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES**

**Neni 1  
Përbërja**

Me këtë Vendim, formohet grupi punues për hartimin e Draft – Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e vendparkingut publik nëntokësor të Komunës së Lipjanit , në përbërje si vijon:

1. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuese,
2. Vlora Krasniqi , Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
3. Bujar Curri, Drejtorati për Inspeksion, anëtar
4. Valdete Muji, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
5. Sazana Demiri Rexhepi, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare

**Neni 2**

**Detyrat e grupit punues**

1. Grupi punues ka për detyrë të bëjë hartimin e dokumentit të Draft – Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e vendparkingut publik nëntokësor të Komunës së Lipjanit , duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore në fuqi më së largu deri më 06.02.2026.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

**Neni 3**

**Hryja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

→ INr. 020/04-731

Lipjan, më 06.01.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore ,nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

### VENDIM

### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE – FURNIZIMEVE, SHËRBIMEVE DHE PUNËVE PËR SHTËPINË E KOMUNITETIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA MENDORE-NGECJE NË ZHVILLIM MENDOR**

#### Neni 1

#### **Përbërja e Komisionit**

Me këtë Vendim formohet Komisioni për pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve,për Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore- ngecje në zhvillim mendor për vitin 2026 , në këtë përbërje:

1. Driton Ibrahim, Kryesues
2. Leona Bytyqi, anëtare
3. Zejnepe Hyseni, anëtare
4. \_\_\_\_\_menaxheri/a i kontratës

#### Neni 2

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore- ngecje në zhvillim mendor për vitin 2026 dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblenjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblenjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.

#### Neni 3

#### **Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

→ INr. 02064-724  
Lipjan, më 06.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore ,nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

### VENDIM

### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE – FURNIZIMEVE, SHËRBIMEVE DHE PUNËVE PËR QENDRËN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE –QKMF NË LIPJAN**

#### Neni 1

#### **Përbërja e Komisionit**

Me këtë Vendim formohet Komisioni për pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve,për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF- në për vitin 2026 , në këtë përbërje:

1. Ragip Hasani, Kryesues
2. Alban Bytyqi, anëtar
3. \_\_\_\_\_menaxheri/a i kontratës

#### Neni 2

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF për vitin 2026 dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblenjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblenjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.

#### Neni 3

#### **Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

→ INr. 020/04-716  
Lipjan, më 06.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligji nr. 08/l-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

#### VENDIM

PËR EMËRIMIN E KOORDINATORIT KOMUNAL TË PERFORMANCËS DHE  
ZYRTARËVE KOMUNALË PËR PERFORMANCË PËR FUSHAT E CAKTUARA NË  
KOMUNËN E LIPJANIT PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS PËR  
VITIN 2025

#### Neni 1 Përbërja

I.Me këtë Vendim, **SHEMSI AZEMI**, në pozicionin e punës Shef i sektorit për tatim në pronë, emërohet **Koordinator Komunal për performancë**, ndërsa **zyrtarë komunalë për performancë për fushat e caktuara** emërohen zyrtarët si vijon:

1. **BURIM GASHI** (fushën e shërbimeve publike administrative)
2. **BUKURIJE ZEJNULLAHU** ( fushën e transparences komunale dhe fushën e përgjegjshmërisë komunale)
3. **ALBERT MUSTAFA** ( fushën për të drejtat e njeriut, shërbime sociale dhe familjare)
4. **RAMIZ GASHI** (fushën e kulturës, rinisë dhe sportit)
5. **GAFURR HETEMI** ( fushën e menaxhimit të fatkeqësive)
6. **ABETARE REXHEPI** (fushën e planifikimit hapësinor komunal, fushën e hapësirave publike komunale dhe fushën e mbrojtjes së mjedisit)
7. **FATBARDHA SHURDHIQI** ( fushën e infrastrukturës rrugore lokale, fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, fushën e kanalizimit dhe higjienës publike dhe fushën e menaxhimit të mbeturinave)
8. **SALIHE MAREVCI** ( fushën e transportit publik komunal dhe fushën e hapësirave për parkim publik )
9. **MERITA ZEQIRI MAGASHI** ( fushën e përfaqësimit gjinor)
10. **BRAHIM DURIQI** (fushën e arsimit parauniversitar)
11. **IZER SINANI** (fushën e kujdesit primar shëndetësor)
12. **LINDA SHAHINI** (fushën e integritetit dhe zhvillimit)

II. Kordinatori dhe zyrtarët komunalë për performance i kanë të përshkruara në mënyrë të përgjithshme detyrat e punës në nenet vijuese 2 dhe 3 ndërsa me këtë Vendim obligohen të hartojnë raportin e performancës vetëm për vitin 2025 me mundësi vazhdimi

## **Neni 2**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Kordinatorit Komunal për Performancë**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kordinatorit komunal për performancë janë:

- Bashkërendon punën e përgjithshme në Komunë për administrimin e sistemit për matjen e performancës,
- Propozon listën e zyrtarëve komunal për performancë(zyrtarëve përgjegjës) për miratim nga kryetari i Komunës dhe udhëheqë punën e tyre në procesin e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave (MVRDH),
- Harton planin e veprimit dhe organizon takime pune me zyrtarët komunal të performancës (ZKP) për metodologjinë e zbatimit të tij për MVRDH në sistem,
- Monitoron procesin e MVRDH në sistem dhe jep udhëzime profesionale ZKP gjatë MVRDH sipas nevojë,
- Bashkërendon punën sipas, nevojë, me drejtoritë përkatëse nëpërmjet drejtorit të administratës,
- Bën verifikimin e të dhënave të raportuara nga ZKP sipas një orari përkatës gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri me 14 shkurt të vitit vijues.
- Përgatitë të dhënat e verifikuara dhe i dërgon për miratim tek kryetari i komunës nëpërmjet drejtorit të administratës deri me 21 janar të vitit vijues për vitin përkatës të raportimit. Në të njëjtën kohë bën verifikimin e të dhënave, nëpërmjet ZKP, nëse kryetari kërkon për shkak të dyshimeve eventuale në saktësinë e tyre,
- Sipas nevojë, bën raportimin e të dhënave të miratuara nga kryetari kur kjo nuk bëhet automatikisht nëpërmjet sistemit,
- Bën arkivimin e të dhënave të miratuara nga kryetari i komunës në kopje fizike në arkivën e komunës apo në arkivën zyrtare të KKP. Një kopje e miratuar nga kryetari i komunës i të dhënave arkivohet në mënyrë automatike nga programi elektronik në bazën e të dhënave në kompjuterin e KKP, të kryetarit të kryetarit të komunës dhe në MAPL- zyrtari përgjegjës për menaxhimin e të dhënave në DPK.

## **Neni 3**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për performancë**

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për performancë janë:

- Harton planin për mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave për fushën përkatëse i ngarkuar nga kryetari i komunës , mbi bazën e kërkesave të KKP.
- Mbledhë, verifikon dhe raporton apo futë të dhëna në sistem gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri me 20 janar të vitit vijues.
- Kujdeset që para futjes së të dhënave në sitem, ta verifikojë saktësinë e të dhënës duke u bazuar vetëm në burimin zyrtarë të të dhënave përkatëse dhe bazuar në dokumente përfundimtare zyrtare, që d.m.th në dokumente të miratuara nga organet përgjegjëse të komunës, të protokoluara dhe me datën përkatëse të protokollimit apo të miratimit, varësisht nga lloji i dokumentit zyrtar.

- Bashkërendon dhe bashkëpunon me përgjegjësitë e njësive përkatëse ku punon dhe prej ku i merr të dhënat dhe me KKP.
- Raporton të dhënat e verifikuara tek KKP, në kopje fizike, kur kjo nuk bëhet në mënyrë automatike nga program elektronik i SMPK. Është përgjegjësi kryesor për saktësinë e të dhënave të raportuara në komunë për SMPK.

#### Neni 4 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet MAPL, Koordinator komunal për performancë dhe zyrtarët komunal për performancë të cekur më lartë.

1Nr. 112/02-3151  
Lipjan, më 020.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E ZYRTARES PËR ZOTIM NË DREJTORATIN PËR ARSIM**

I. Me këtë Vendim **FLORANDA ZEQRIRI HETEMAJ**, Zyrtare në Drejtoratin për Arsim, **CAKTOHET**, Zyrtare për zotim për lëndët nga fusha e arsimit.

II. E lartëcekura sipas nevojës së Drejtoratit Komunal për Arsim do ti kryej detyrat si Zyrtare për zotim për lëndët nga fusha e arsimit.

III Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Arsim dhe dhe zyrtarja e lartëcekur.

1Nr. 112/02-3518  
Lipjan, më 22.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 6 të Rregullores për ndarjen e busave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 NR.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BURSIVE DHE SHUMËS FINANCIARE PËR NJË BURSË PËR**  
**STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK 2025/2026**

**Neni 1**

Me këtë Vendim CAKTOHET që për vitin akademik 2025/2026 të ndahen 400 (katërqind) bursa dhe shuma financiare për një bursë do të jetë 500 € (pesëqind) euro.

**Neni 2**

Obligohet, Drejtorati për Arsim që menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi të përgadisë Thirrjen publike për aplikim, konform kriterëve të përcaktuara e dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22594 të datës 28.04.2023 dhe të njëjtën ta publikojë në faqen zyrtare të Komunës, në njërën nga gazetatat ditore me trash të madh dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

**Neni 3**

Shuma e cekur nga neni 1 i këtij Vendimi do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria e subvencioneve në xhirollogaritë personale të secilit përfitues të zgjedhur.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

INr. 400/01 - 2953  
Lipjan, më: 22.01.2026

Kryetari i Komunës së Lipjanit  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 44 të Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, merr

## VENDIM

### PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR

#### Neni 1

#### Themelimi dhe Përbërja

Me këtë Vendim themelohet Komisioni Komunal për rintegrimin e personave të riatdhesuar (në vazhdim të tekstit komisioni) në përbërje, si vijon:

1. Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesues
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Rozeta Selimi, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare
4. Ismet Gashi, Enti për punësim-Lipjan, anëtar
5. Xhelil Murati, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
6. Abetare Rexhepi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
7. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
8. Linda Shahini, Zyrtare për Integritet Evropian anëtare,
9. Arbëresha Hetemi, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
10. Zyrafete Bytyqi Mavriqi, Qendra për punë sociale, anëtare

#### Neni 2

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë

Komisioni merr vendime për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitim nga skemat e riintegritetit si në vijim:

1. akomodim me qira;
2. asistencë mjekësore;
3. rindërtim dhe/ose renovim të shtëpive;
4. pako të orendive shtëpiake.

Komisioni shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave të riatdhesuar në harmoni me Rregulloren (QRK) Nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe me

Ligjin për Procedurë të Përgjithshme Administrative. Vendimet e Komisionit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve prezentë, brenda afatit sa më të shkurtër kohor por jo me vonë së shtatë (7) ditë, nga dita e pranimi të kërkesës për skemat emergjente.. Për skemat tjera, Komisioni merr vendim brenda periudhës kohore prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të kërkesës. Vendimi i Komisionit i dërgohet parashtruesit të kërkesës jo më vonë së shtatë (7) ditë pas nënshkrimit të tij nga kryetari i komunës. Komisioni diskuton dhe adreson sfidat e personave të riatdhesuar për qasje në shërbime publike dhe riintegrim të qëndrueshëm.

### Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyra Lokale për Komunitete dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 020/04-3519  
Lipjan, më 22.01.2026

IMRI AHMETI  
KRYETARI I KOMUNËS





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

### VENDIM

#### MBI PËRCAKTIMIN E DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË REPREZENTACIONIT

I. Me këtë Vendim përcaktohet e drejta për shfrytëzimin e reprezentacionit për pije për vitin 2026, për anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe trupat tjerë të kuvendit të themeluar me vendime të Kuvendit të Komunës..


II. E drejta e shfrytëzimit të e reprezentacionit e cekur në pikën I të këtij Vendimi do të shfrytëzohet gjatë mbajtjes së takimeve - seancave.

III. Pagesa për shfrytëzimin e reprezentacionit do të bëhen nga kategoria buxhetore - pozicioni : mallra dhe shërbime të planifikuara për Kuvendin e Komunës.

IV.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohen: Drejtorati për Buxhet dhe Financa , Drejtorati për Prokurim dhe Kryesuesi i Kuvendit Komunal .

1Nr. 400/01-2496  
Lipjan, më 19.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

### VENDIM

#### MBI PËRCAKTIMIN E SHUMËS SË SHPENZIMEVE TË REPREZENTACIONIT PËR POZICIONET E PUNËS

I. Me këtë Vendim përcaktohet shuma mujore e të drejtës për shfrytëzimin e reprezentacionit për vitin 2026, për pije për vizitorët në Zyrën e Kryetarit të Komunës e cila do të jetë varësisht prej nevojës dhe arsyeshmërisë dhe pozicionet tjera si në vijim:

| Nr. | Pozicioni i punës                                 | Numri i kryersve | Shuma mujore                                           |
|-----|---------------------------------------------------|------------------|--------------------------------------------------------|
| 1.  | Kryetari i Komunës                                | 1                | E palimituar ,varësisht prej nevojës dhe arsyeshmërisë |
| 2.  | Nënkryetarët e Komunës                            | 2                | 40 €                                                   |
| 3.  | Kryesuesi i Kuvendit                              | 1                | 30 €                                                   |
| 4.  | Drejtorët e Drejtorateve Komunale                 | 13               | 30 €                                                   |
| 5.  | Drejtori i QKMF-së - Lipjan                       | 1                | 30 €                                                   |
| 6.  | Drejtor i QPS-së Lipjan                           | 1                | 30 €                                                   |
| 7.  | Shef i Kabinetit të Zyrës së Kryetarit të Komunës | 1                | 30 €                                                   |
| 8.  | Zëdhënës/e i Komunës                              | 1                | 30 €                                                   |
| 9.  | Shef/e i Zyrës Lokale për Komunitete              | 1                | 20 €                                                   |

II. Shuma e përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi do të shfrytëzohet në zyrën e Kryetarit të Komunës, Nënkryetarëve, Drejtorëve të Drejtorateve Komunale, Drejtorit të QKMF-së, Drejtorit të QPS-së, Shefit të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, Zëdhënësit/es të Komunës dhe Shefit të Zyrës Lokale për Komunitete për reprezentacion për vizita zyrtare .

III. Pagesa për shfrytëzimin e reprezentacionit do të bëhen nga kategoria buxhetore - pozicioni mallra dhe shërbime të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorateve përkatëse.

IV.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohen: Drejtorati për Buxhet dhe Financa , Drejtorati për Prokurim dhe bartësit e funksioneve të cekura.

1Nr. 400/01-2569

Lipjan, më 19.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

